



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



E K S T R A K T

**i procesverbalit nga mbledhja e parë e Komitetit për Komunitete, mbajtur më 25.05.2022,
duke filluar në orën 10:00**

Në mbledhje morën pjesë: Arton Brahim, Elmira Nikçi Rexha, Nenad Miladinovic, Oktay Kurtesh, Triera Kasumi Berisha, Adnan Ajeti, Kimeta Shok, Mirsada Behluli.

Mungoi : Faton Marolli.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e Komitetit për Komunitete me këtë:

R E N D T Ë D I T Ë S

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Prezantimi i përfaqësuesve të komuniteteve;
3. Formimi i grupit për hartimin e planit të punës së KK-s për vitin 2022;
4. Formimi i Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave i KK-s;
5. Formimi i Komisionit për vizita në shkollat ku vijojnë mësimin nxënësit e komuniteteve jo shumicë;
6. Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve jo shumicë lidhur me gjendjen në bashkësinë e tyre;
7. Raporti i ZKKK-s për muajin Prill 2022;
8. Të ndryshme.

Pika e parë

Shqyrtimi i dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Pika e dytë

Prezantimi i përfaqësuesve të komuniteteve

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës anëtarët e Komitetit për Komunitete bënë prezantimin e tyre pasi që Komiteti për Komunitete ka pësuar ndryshime tek kryesuesi dhe anëtarët e Komitetit për Komunitete.

Pika e tretë

Formimi i Grupit për hartimin e Planit të punës së KK-s për vitin 2022

Në bazë të pikës 3 të Rendit të Ditës, është formuar Komisioni për Hartimin e Planit të Punës së KK-së për vitin 2022 si në vijim:

1. **Mirsada Behluli - Kryesuese e KK-së,**
2. **Nenad Miladinoviq - Përfaqësues i komunitetit serb,**
3. **Kimeta Shok - Përfaqësuese e komunitetit goran dhe**
4. **Klaudia Mula - Zyrtare për komunitete dhe mundësi të barabarta ZKKK**

Pika e katërt

Formimi i Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave i KK-s

Në bazë të pikës 4 të Rendit të Ditës, është formuar Komisioni për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Ankesave të KK-së për vitin 2022 si në vijim:

1. **Oktay Kurtesh - Përfaqësues i komunitetit turk,**
2. **Arton Brahimi - Përfaqësues i komunitetit shumicë dhe**
3. **Meral Aygun - Zyrtare për komunitete dhe mundësi të barabarta ZKKK**

Pika e pestë

Formimi i Komisionit për vizita në shkollat ku vijojnë mësimin nxënësit e komuniteteve

Në bazë të pikës 5 të Rendit të Ditës, është formuar Komisioni për vizita në shkollat ku vijojnë mësimin nxënësit e komuniteteve, në kuadër të KK-së për vitin 2022 si në vijim:

1. **Triera Kasumi Berisha- Përfaqësuese e komunitetit shumicë,**
2. **Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe**
3. **Përfaqësuesit e komuniteteve**

Pika e gjashtë

Raportimi i përfaqësueseve të komuniteteve jo shumicë lidhur me gjendjen në bashkësinë e tyre

Mirsada Behluli

A ka dikush të thotë diçka rreth kësaj pike të rendit të ditës.

Nenad Miladinovic - sa i përket gjendjes së sigurisë tha se nuk kemi kurrfarë problemesh. Mirëpo desha të cekim problemin e kanalizimit, ku që dy muajt e fundit në disa pjesë të fshatit kemi problem me kanalizim dhe se për banorët e asaj pjesë është problem pasi që tani ka filluar koha e nxehtë dhe mund të vijë deri tek ndonjë epidemi.

Ai në vazhdim tha se jemi munduar ta rregullojmë këtë problem përmes Kompanisë së Ujësjetës por nuk kemi arritur, pastaj i jemi drejtuar Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe më është thënë se do të dalin në terren drejtori Krenari së bashku me ekipin.

Ku pas takimit besoj se do të kuptoj se çka ka ndodhur.

Ai mes tjerash tha se ne si Komitet jemi munduar të punojmë dhe do të punojmë prapë për zgjidhjen e problemeve përmes drejtorive tona përkatëse.

Kimeta Shok - tha se nuk ka diçka konkrete, vetëm se shtroi shqetësimin lidhur me një mësimitdhënës i komunitetit boshnjak nga lënda e Gjeografisë i cili shkon në pension e është duke u përfolur se në vend të tij do të pranohet një nga komuniteti shumicë i cili nuk e njeh gjuhën boshnjake.

Ajo në vazhdim tha se ju kisha lutur si Komitet dhe si Zyre për komunitete që nëse ka dikush nga komuniteti boshnjak me arsimim adekuat të merret parasysh që të pranohet në vend të mësimitdhënësit nga komuniteti boshnjak, pasi që do të ishte më lehtë për komunikimin në mes nxënësve dhe mësimitdhënësve.

Mirsada Behluli - lidhur me shqetësimin e znj. Shok tha se besoj se nuk do të ketë problem nëse do të gjendet personi me arsimim adekuat nga komuniteti boshnjak.

Klaudia Mula - lidhur me shqetësimin e paraqitur nga znj. Shok lidhur me çështjen e mësimitdhënësit i komunitetit boshnjak nga lënda e Gjeografisë në shkollën fillore "Naim Frashëri" në Prishtinë i cili shkon në pension tha se kjo letë shkon si rekomandim nga Komiteti për Komunitete tek Drejtorja e Arsimit.

Oktay Kurtesh - po ashtu problemin e njëjtë e kemi edhe tek komuniteti turk, ku thotë se vërtet kemi lutje që të keni parasysh që kur është puna tek pranimi i mësimitdhënësve në shkollë ku vijojnë mësimin nxënësit e komunitetit turk apo boshnjak të kihen parasysh personat me arsimim adekuat që ju përkasin atyre komuniteteve.

Triera Kasumi Berisha - lidhur me diskutimin e z. Kurtesh tha se kjo çështje më duket pak sa diskriminuese, përderisa ai e njeh gjuhën turke apo boshnjake nuk paraqet problem të jap

mësim, pasi që ne kemi komunitete jo shumicë të ndryshme, ku mendoj se nuk është e rëndësishme të jetë i po atij komuniteti.

Oktay Kurtesh - duke u ndërlidhur me diskutimin e znj. Kasumi - Berisha tha se nuk thash që nuk bënë por nëse ka persona me arsimim adekuat nga komuniteti turk apo boshnjak të kenë përparësi.

Betim Abdullahu - lidhur me diskutimin e z. Kurtesh tha se Ligji për Shërbyes Civil nuk i jap përparësi asnjë komuniteti të caktuar për me u zgjedh arsimtarë me direktivë të veçantë. Mirëpo nëse ndonjë shkollë kërkon arsimtarë të gjuhës turke mundet dikush nga komuniteti shqiptar i cili ka kryer Fakultetin e Edukimit në gjuhën turke mundet me u zgjedh me të drejta të barabarta. Pasi që Prishtina nuk ka shkolla të ndara specifike që mësohet p.sh direkt vetëm në një gjuhë edhe nuk punon me plan program të Republikës së Kosovës. Pra kjo është arsyeja që ne as si Komitet e as si Zyre nuk mundemi me ndikuar tek Ligji për Shërbyesit Civil.

Elmira Nikçi Rexha - lidhur me diskutimin e znj. Shok dhe z. Kurtesh tha se e kuptojmë mirë shqetësimin e të gjithëve pa përjashtim të asnjë komuniteti. Mirëpo ne nuk jemi ata që i bëjmë ligjet, ne vetëm se i zbatojmë ato, dhe se ne prej këtij takimi mundemi të dalim me një rekomandim të cilin do t'ia drejtojmë Drejtorisë së Arsimit. Ajo mes tjerash tha se sa i përket shqetësimeve që keni ju propozoj që mos ta prisni mbledhjen e Komitetit por ato ti drejtoni më herët në drejtoritë përkatëse ose individualisht ose përmes ZKKK-s, pasi mbledhja mundet edhe të mos mbahet.

Adnan Ajeti - sa i përket gjendjes së sigurisë nuk kemi problem, vetëm se kemi problem me mbeturina që janë bërë si deponi në lagjen "Moravska" .

Pika e shtatë

Raporti i ZKKK-s për muajin Prill 2022

Betim Abdullahu- në pika të shkurta i njoftoi të pranishmit lidhur me punën dhe aktivitetin e ZKK-s, si çdo herë duke zbatuar Planin e veprimit dhe Rregulloret që dalin nga ministritë e linjës për punën tonë.

Ai në vazhdim cekti disa prej aktiviteteve si p.sh takimet me shumicën e organizatave ndërkombëtare të cilat mbështesin të gjitha komunitetet në Kosovë, si dhe në Komunën e Prishtinës, inicimin e të gjitha projekteve të ZKKK-s për komunitetet që jetojnë në Komunën e Prishtinës, vizitat e komuniteteve jo shumicë me rastin e ditës së bashkësive të tyre së bashku me kryetarin etj.

Njëzëri u miratua Raporti i ZKKK-s për muajin Prill 2022.

Pika e tetë
Të ndryshme

Mirsada Behluli - lidhur me këtë pikë të rendit të ditës shtroi çështjen e vend ndalimit të autobusit 7C në Kalabri, ku kërkon që ndalja e parë të jetë tek rrethi i Flamurit pikërisht tek "Viva Fresh Store" ku ekziston parkingu për udhëtarë dhe mendoj se do të ishte vend i përshtatshëm për vend ndaljen e autobusit 7c, pasi që ndalja e parë është tek AAK-ja dhe banorët e asaj lagje e kanë larg vend ndaljen e autobusit.

Pra e gjithë kjo me arsyetim të banorëve të lagjes Kalabria pasi që aty janë tri shkolla, njëra në Dardani aty mbrapa Termokosit, përballë është shkolla e mesme "Ali Sokoli" si dhe shkolla fillore "Hasan Prishtina". Kështu që qytetarët kanë nevojë për sigurinë e fëmijëve të tyre, pasi që fëmijët janë të rrezikuar për ta kaluar rrugën.

Nenad Miladinovic - tha se sot patëm takimin e dytë të Komitetit dhe sinqerisht të ju them se i jam falënderues z. Kupina për kontributin e madh të dhënë ku mungesa e tij edhe sot mungon, pasi që ai ka qenë njeri me shumë ide, ka njohur shumë njerëz dhe është munduar që të ju ndihmoj të gjithëve në zgjidhjen e problemit.

Ai në vazhdim tha se në njërin prej takimeve para 3-4 viteve kemi shtruar kërkesë që të mundësohet hapja e nga një zyre për çdo komunitet ku me këtë do të ju ndihmonim atyre me punësimin e nga një përfaqësuesi të komuniteteve të tyre.

Lidhur me këtë kemi pasur disa premtime por të cilat nuk janë realizuar deri në fund.

Ai mes tjerash propozoi që lidhur me këtë të shkohet tek kryetari i Komunës dhe të bisedohet me të ku në këtë mënyrë do ti kishim ndihmuar të gjitha komuniteteve jo shumicë.

Oktay Kurtesh - duke u ndërlidhur me diskutimin e z. Miladinovic tha se atëherë tema ka qenë se nuk ka zyre në Komunë, por mundemi me shkuar me marr ndonjë lokal me qira për ta shfrytëzuar si zyre në atë pjesë ku jetojnë shumica e komuniteteve, ku unë kam shkuar dhe kam bërë kontratë në të vërtetë parakontratë për lokal ashtu siç më kanë kërkuar dhe i kam sjell por ajo është harruar.

Triera Kasumi Berisha - shtroi pyetje se si ka qenë e planifikuar me i dhënë zyrat dhe çfarë shërbimi kishin me kryer ato zyra.

Oktay Kurtesh - duke iu përgjigjur znj. Kasumi - Berisha tha se ato zyra do të shërbenin për kërkesa dhe ankesa të qytetarëve të komuniteteve jo shumicë.

Klaudia Mula- duke iu drejtuar të pranishmëve sidomos komuniteteve jo shumicë bëri ftesë që po që se kanë projekte ti sjellin në ZKKK-s.

Meral Aygun - shtroi çështjen e shkollës së mesme "Sami Frashëri" në Prishtinë, e cila do të rinovohet në muajin Shtator, prandaj kisha me kërkuar që me ndihmën dhe përkrahjen e juaj që nxënësit e kësaj shkolle të barten në shkollën e mesme të afërt "Ahmet Gashi" gjatë renovimit të shkollës "Sami Frashëri"

Pas disa diskutimesh, propozimesh, sugjerimesh Komiteti për Komunitete ka nxjerr këto;

KONKLUSIONE

1. Për takimin e radhës të ftohet drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike
2. Për takimin e ardhshëm të ftohet drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit
3. Komiteti për Komunitete në bashkëpunim me ZKKK-s të përcjellë shqetësimin e znj. Shok tek Drejtoria e Arsimit, që ka të bëjë me mësimdhënësin nga komuniteti boshnjak për lëndën e Gjeografisë i cili shkon në pension që mundësisht të zëvendësohet me personin adekuat nga komuniteti boshnjak.
4. Komiteti për Komunitete në bashkëpunim me ZKKK-s të përcjellë shqetësimin e znj. Aygun që ka të bëjë me çështjen e shkollës së mesme "Sami Frashëri" në Prishtinë, e cila do të rinovohet në muajin Shtator, prandaj kisha me kërkuar që me ndihmën dhe përkrahjen e juaj që nxënësit e kësaj shkolle të barten në shkollën e mesme të afërt "Ahmet Gashi" gjatë renovimit të shkollës "Sami Frashëri".

Procesmbajtësja
Lendita Spahija

Kryesuesja e Komitetit për Komunitete
Dr. Mirsada Behluli

Behluli

